



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *k2/AGG-7* Prot.
Nr. Dok. 201901109/7

Tiranë *28/02/2020*

Lënda : *Rekomandim për pajisjen e shtetasit *** me certifikatën e punonjësit të shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike*

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT
Drejtues Madhor Ardi Veliu
Tiranë

I nderuar Zoti Veliu,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi *** Ankuesi shkruan se, në muajin nëntor 2018 ka aplikuar në Drejtorinë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë për t'u pajisur me certifikatë si punonjës i shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, por kërkesa i është refuzuar. Sipas ankuesit, refuzimi i kërkesës së tij është bërë në mënyrë të padrejtë sepse ai i plotëson të gjitha kriteret ligjore për t'u pajisur me një certifikatë të tillë. Gjithashtu ai pretendon se ka qënë i pajisur edhe më parë me këtë lloj certifikate për një periudhë kohore prej 4 vjetësh nga viti 2012 deri në vitin 2016.

Në bazë të kërkesës tonë, DVP Tiranë me shkresën nr. 8321/1K prot., datë 13.10.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se nga verifikimi i dokumentacionit që ndodhet në Seksionin e Shërbimit ndaj të Tretëve në DVP Tiranë rezultoi se, shtetasi *** ka aplikuar pranë Komisarariatit të Policisë Vorë në muajin dhjetor 2018 për t'u pajisur me certifikatë sipas kriterëve të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2019 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike". Shtetasi *** ka qënë i pajisur me certifikatë si punonjës shërbimi me nr. 3532, datë 05.03.2012. Praktika e shtetasit *** është shqyrtuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikimin e punonjësve të shërbimit (KSHKC-së) në DVP Tiranë në datën 24.06.2019.

Me vendimin e Drejtorit të DVP Tiranë nr. 471/26, datë 08.07.2019 shtetasit *** i është refuzuar pajisja me certifikatë për arsye se është gjetur në shkelje të nenit 12, pika 1, gërma "ë" të ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", ku parashikohet se:

“ë) të mos jetë ndëshkuar me masë disiplinore “Përfashtim nga Policia e Shtetit” ose “Lirim nga Forcat e Armatosura”.

Shtetasi *** me shkresën nr. A-326 prot., datë 05.08.2019 ka bërë ankesë drejtuar Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në DVP Tiranë. Ky komision ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KSHKC-së nr. 471/26, datë 08.07.2019, refuzimin e kërkesës për pajisjen me certifikatë të punonjësit të shërbimit shtetasi *** , pasi është në kundërshtim me nenin 12, pika 1, gërma “ë” të ligjit nr. 75/2014.

Sipas DVP Tiranë, pretendimi i shtetasit *** se refuzimi i pajisjes me certifikatë është i padrejtë dhe se ai i plotëson të gjitha kriteret ligjore për t’u pajisur me certifikatë si punonjës shërbimi nuk qëndron, sepse refuzimi është bërë në përputhje me ligjin nr. 75/2014.

Gjithashtu kjo drejtori na informoi se, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga IEVP Fushë Krujë me nr. 3699, datë 14.12.2018, vërtetohet se shtetasi *** ka punuar pranë këtij institucioni me detyrë punonjës i rolit bazë të Policisë së Burgjeve nga data 21.08.2008 deri në datën 05.07.2010. Vërtetimi i mësipërm nuk ka motivacionin e lirit të tij nga detyra si punonjës i rolit bazë të Policisë së Burgjeve pranë këtij institucioni.

Në vijim të përgjigjes së dërguar DVP Tiranë na informoi se, shtetasi *** së bashku me ankesën ka dorëzuar edhe kopjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1729, datë 13.09.2019, në të cilin parashikohet se kjo gjykatë ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9093, datë 04.10.2012.

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë.

*Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të dëmshpërblejë paditësin. *** me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të justifikuar”.*

Përveç sa më sipër, në këtë përgjigje na informoi se, shtetasit *** i është refuzuar pajisja me certifikatën e punonjësit të shërbimit si ish ushtarak sipas nenit 12, pika 1, gërma “ë” të ligjit nr. 75/2014, por ai gëzon të drejtën për të aplikuar si shtetas dhe pajisjen me certifikatë nëse plotëson kriteret ligjore, duke kryer kursin bazë dhe pajisjen me “Dëshmi Aftësie” për punonjës shërbimi, parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 505, datë 26.10.2018 “Për Qendrat e Trajnimit Privat”.

Nga ankesa e shtetasit *** dhe përgjigjia e dërguar nga DVP Tiranë konstatuam se ankuesit i është shkëlur një e drejtë ligjore e parashikuar në ligjin nr. 75/2014 neni 12, pika 1 ku janë parashikuar kriteret për certifikimin e punonjësit të shërbimit.

Mosdhënia e certifikatës së punonjësit të shërbimit me justifikimin se shtetasi *** ka punuar në detyrën e punonjësit të rolit bazë të Policisë së Burgjeve në IEVP Fushë Krujë nga datë 21.08.2008 deri në datën 05.07.2010 dhe është liruar nga kjo strukturë, është jo vetëm e pabazuar në ligj, por vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me të.

Fakti që ankuesi ka qënë për 12 vjet punonjës i Policisë së Burgjeve dhe është larguar nga kjo strukturë është i njohur nga ana jonë. Pas largimit nga detyra ankuesi me cilësinë e paditësit ka ngritur kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me objekt, ndërmjet të tjerave, edhe anulimin e Urdhrit nr. 5935/1, datë 02.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Në përfundim të gjykimit të kërkesë padisë së tij, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1729, datë 13.09.2019 ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9093, datë 04.10.2012, në këtë mënyrë:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë.

- Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të dëmshpërblejë paditësin . *** me pagën e 12 (dymbëdhjetë) muajve për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara.

- Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, t'i paguajë paditësit *** pagën e 3 (tre) muajve për mos respektimin e afatit të njoftimit.

- Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të shpërblejë paditësin me pagën e 2 (dy) muajve e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për vjetërsi shërbimi.

- Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të kërimit.

- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve në raport me pjesën e pranuar dhe të rrëzuar të padisë”.

Ndërkohë konstatoam se DVP Tiranë ishte njohur me vendimin gjyqësor të cituar më sipër, sepse atë ia ka vënë në dispozicion ankuesi. Këtë fakt ajo e ka pranuar në përgjigjen e dërguar institucionit tonë ku shprehet se, shtetasi . *** në ankesën e bërë në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në DVP Tiranë ka dorëzuar edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. 1729, datë 13.09.2019.

Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të cituar më sipër rezulton se, paditësi ka punuar në Policinë e Burgjeve për një periudhë kohore prej 12 vitesh, fillimisht në Spitalin e Burgjeve Tiranë deri më 23.07.2003. Pasi është larguar nga ky institucion, ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në datën 19.05.2005, fillimisht në IEVP “Mine Peza” Tiranë dhe më pas në IEVP Fushë Krujë deri në datën 05.07.2010, kur është larguar nga detyra me Urdhrin nr. 5935/1, datë 02.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Gjithashtu nga pjesa arsyetuese e këtij vendimi rezulton se, largimi nga detyra i paditësit (ankuesit) *** nuk është në përputhje me rrethanat e faktit dhe se pala e paditur nuk ka arritur të saktësojë nëse ka ndodhur vërtet shkelja, por edhe nëse ka ndodhur, ajo nuk është shkelje e rëndë dhe as e përsëritur për paditësin në kuptimin e nenit 153 të Kodit të Punës.

Gjykata ka vlerësuar se, zgjidhja e kontratës së punës mes palëve është ndërprerë pa shkaqe të justifikuara dhe për këto arsye ka vendosur si më lart cituam, dëmshpërblimin e tij.

Sjellim në vëmendje se, ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, Kodi i Punës dhe Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 31, datë 14.04.2003, nuk parashikojnë rikthimin në punë të punonjësve të administratës publike edhe në rastet ku provohet se largimi i tyre është bërë në mënyrë të kundërligjshme, sikurse ka ndodhur edhe me shtetasin . *** Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 31, datë 14.04.2003, ndërmjet të tjerave shprehet se: “... me anë të ankimit në gjykatë punonjësi i policisë, ashtu si dhe një numër tjetër punonjësish publik që kanë detyra të caktuara shërbimi ndaj shtetit, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur, edhe në qoftë se provohet që janë larguar prej saj pa shkaqe të përligjura”. “E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pala që dëmtohet nga një pushim i pa drejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore”. Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76 të vitit 2003, për njësimin e praktikës gjyqësore.

Pra, në raste të tilla, gjykata iu jep të larguarve nga puna dëmshpërblimin deri në masën e 12 pagave mujore të cilit mund t'i shtohen edhe detyrimi i punëdhënësit për të paguar punëmarrësin për mos respektimin e afatit të njoftimit të procedurës së largimit dhe për vjetërsinë në punë.

Sikurse rezulton nga dokumentacioni i administruar nga institucioni ynë gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, në rastin e gjykimit të kërkesë padisë së shtetasit

nga Gjykata e Apelit Tiranë është mbajtur i njëjti qëndrim, duke i dhënë dëmshpërblim për largimin e padrejtë nga detyra, si dhe shpërblimin për mos respektimin e afatit të njoftimit dhe për vjetërsinë në punë. Pra, shkak i largimit nga detyra të shtetasit *** është konsideruar i padrejtë dhe jo në përputhje me ligjin nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1729, datë 13.09.2019. Ky vendim gjykate ka konstatuar se zgjidhja e kontratës ka qenë në kundërshtim me ligjin. Për më tepër urdhri i largimit nga puna nuk përbën në këto raste kur marrëdhënia rregullohet nga Kodi i Punës akt të mirfilltë administrativ të mbetur në fuqi pas përfundimit të kontratës. Koncepti i dëmshpërblimit në vetvete është kompensim i dëmit të shkaktuar nga veprimi/mosveprimi i padrejtë i kryer nga një person tjetër. Ndodhur në këto rrethana, shtetasi *** nuk ka pengesa ligjore për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit.

Përveç sa më sipër konstatuam se, nëse do t'i referohemi në mënyrë rigoroze ligjit nr. 75/2014, dhe konkretisht nenit 12, pika 1¹, gërma "ë" rezulton se ankuesi nuk ka pengesë ligjore për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit, sepse ai nuk ka qenë pjesë e Policisë së Shtetit apo e Forcave të Armatosura. Sipas nenit 168/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, *Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga forcat tokësore, detare dhe ajrore*. Pra, edhe nëse ankuesi nuk do të kishte fituar gjyqin me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ai nuk ka pengesë ligjore për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit, sepse largimi nga Policia e Burgjeve ku ai ka punuar nuk është parashikuar në këtë dispozitë ligjore si kusht për të mos u pajisur me lejen, objekt ankimi.

Gjithashtu konstatuam se edhe qëndrimi i mbajtur nga DVP Tiranë se, shtetasit *** i është refuzuar pajisja me certifikatën e punonjësit të shërbimit si ish ushtarak sipas nenit 12, pika 1, gërma "ë" të ligjit nr. 75/2014, por ai gëzon të drejtën për të aplikuar si shtetas dhe pajisjen me certifikatë nëse plotëson kriteret ligjore, duke kryer kursin bazë dhe pajisjen me "Dëshmi Aftësie" për punonjës shërbimi, parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 505, datë 26.10.2018 "Për Qendrat e Trajnimit Privat", nuk është korrekt dhe i bazuar në ligj sepse vjen në kundërshtim me nenin 12/2² të ligjit nr. 75/2014. Sikurse u përshkrua edhe më sipër, shtetasi *** është ish punonjës i strukturave ligjzbatuese dhe konkretisht i Policisë së Burgjeve për 12 vjet dhe për këto arsye ai nuk duhet të kryejë kursin e nevojshëm profesional dhe testimin e sugjeruar nga DVP Tiranë. Sjellim në vëmendje se aktet normative miratohen për të rregulluar marrëdhënie të caktuara juridike. Në rastin në fjalë, pajisja e një shtetasi me certifikatën e punonjësit të shërbimit është rregulluar nga ligji nr. 75/2014. Ndërkohë në këtë ligj, respektivisht në nenin 12, pika 1, gërma "ë" janë parashikuar edhe kriteret që duhet të plotësojë një person për fitimin e kësaj të drejte. Ligji përbën fillimin dhe

¹ 1. Pajiset me certifikatën e punonjësit të shërbimit personi që plotëson këto kriteret:

- a) të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) të ketë aftësi fizike e mendore për të kryer detyrën, të vërtetuar me raportin mjekësor nga komisioni përkatës;
- ç) të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- d) të ketë kryer arsimin e mesëm;
- dh) të përmbushë kriterin e besueshmërisë, sipas kuptimit që i jep ky ligj;
- e) të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale;
- ë) të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore "Përkrahim nga Policia e Shtetit" ose "Lirim nga Forcat e Armatosura".
- f) të ketë kryer, në qendrën e trajnimit të licencuar, kursin e nevojshëm profesional dhe të jetë pajisur me dëshminë përkatëse.

² 2. Kur personi që kërkon të pajiset me certifikatën e punonjësit të shërbimit të sigurisë fizike është ish-punonjës i Policisë së Shtetit apo i strukturave të tjera ligjzbatuese, me gradë policore e ushtarake, nuk kryen kursin e nevojshëm profesional dhe testimin.

mbarimin e veprimtarisë administrative. Nëse ligji nuk e parashikon, organi administrativ nuk mund të kërkojë plotësimin e kriterëve shtesë, sikurse është sugjeruar për ankuesin nga DVP Tiranë.

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës ligjore të shkelur shtetasit *******, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gjermën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, me shkresën nr. K2/A64-4 prot., datë 11.12.2019, drejtuar DVP Tiranë i rekomanduam si më poshtë:

*“Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e shtetasit ******* me certifikatën e punonjësit të shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.*

DVP Tiranë me shkresat nr. 525 prot., datë 16.01.2020 dhe nr. 969/1 prot., datë 05.02.2020, ndërmjet të tjerave na informoi se, shtetasit ******* nuk i është shkelur asnjë e drejtë, sepse bazuar në kriteret e nenit 12, pika 1, gjërma “ë” dhe pika 2 të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” janë të shënuara se cilët punonjës dhe të cilës strukturë mund të aplikojnë pa kryer kursin bazë dhe se një ndër detyrimet që duhet të përmbushë është të mos jenë të ndëshkuar me masa disiplinore nga këto institucione. Ai nuk mund të aplikojë si ish ushtarak dhe t’i shmangët detyrimin për të mos qënë i ndëshkuar me masa disiplinore nga kjo strukturë.

Gjithashtu në përgjigjet e dërguara, DVP Tiranë na bën me dije se nga ana jonë është interpretuar gabim vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, sepse dhënia e 12 pagave mujore si dëmshpërblim shtetasit ******* nuk do të thotë se është shfuqizuar Urdhri nr. 5935/1, datë 02.07.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për “largim nga detyra”. Sipas DVP Tiranë, kjo kuptohet edhe duke iu referuar objektit të padisë dhe dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku nuk rezulton që të jetë shfuqizuar masa e dhënë shtetasit ******* me Urdhrin nr. 5935/1, datë 02.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Ne vlerësojmë se përgjigjia e kthyer nga DVP Tiranë nuk është korrekte dhe në përputhje me ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1729, datë 13.09.2019 në të cilat referohet. Në rastin konkret, sikurse argumentuam edhe më sipër shtetasi ******* nuk ka asnjë pengesë ligjore për t’u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike.

Meqënëse DVP Tiranë nuk e ka pranuar rekomandimin tonë, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen;”*

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të nevojshme në cilësinë e organit epror të DVP Tiranë për pajisjen e shtetasit ******* me certifikatën e punonjësit të shërbimit në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike.


Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihem në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi S. Nushi



Handwritten signature of Konceptoi S. Nushi, dated 28/02/20.



Handwritten signature of Ermonela Ruspi.